



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 883 Prot.

Tiranë, më 06.07 2018

VENDIM Nr. 117, datë 27.06.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 27.06.2018, pasi shqyrtoj Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Korpus Universitar "Universiteti "Aldent" 4 kat, me 1 kat nëntokë" ndodhur në Lundër, Farkë-subjekti Z. Adem Alushi, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Korpus Universitar "Universiteti "Aldent" 4 kat, me 1 kat nëntokë" ndodhur në Lundër, Farkë-subjekti Z. Adem Alushi, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**